



**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

**Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore**

Lëndët/Pozitat: 14. Një bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve nga lëndët:

Lëndët/Pozitat:

1. Ekofiziologji (O-Eko) Msc
2. Ekotoksikologji (O-Eko) Msc
3. Fiziologji e përgjithshme (O-Bio) Bsc
4. Fiziologji e shtazëve (O-BioM) Bsc
5. Fiziologji e shtazëve (O-Eko) Bsc
6. Fiziologji krahasuese (O-Bio) Bsc
7. Hulumtimi në laborator dhe vivariumi (Z-Bio) Bsc
8. Kafshët laboratorike në hulumtime në biologjinë molekulare (O-BioM) Bsc
9. Kapituj të zgjedhur nga Fiziologjia animale (O-Bio) Msc
10. Makro dhe mikroanatomia e shtazëve laboratorike (Z-Bio) Msc
11. Menaxhimi dhe mbrojtja e tokave (Z-Eko) Msc
12. Metodat hulumtuese të acideve nukleike dhe proteinave (O-BioM) Bsc
13. Parimet e qëndrueshmërisë mjedisore (Z-Eko) Bsc
14. Preparimi i shtazëve (Z-Bio) Msc

Komisioni vlerësues (prej 5 ose 3 anëtarëve):

1. Kryetar Prof. Dr. Kemajl Bislimi
2. Anëtar Prof. Ass. Ilir Mazreku
3. Anëtar Prof. Dr. Elez Krasniqi

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE  
PRISHTINË

Oranuar me: 30.08.2024			
Nr. Org	Numër	Sasia	Vlera
01	2884	3	-



Kandidatët e paraqitur sipas pozitave/lëndëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rendor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitave apo kandidatëve):

1. Djelza Panxhaj
2. Ylli Krasniqi
3. Granit Osaj
4. Avdyll Bajrami
5. Besnik Dakaj
6. Mirlinda Dehari Zeka
7. Besa Brahim Balaj

#### RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

*(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohen për angazhim si bashkëpunëtorë të jashtëm).*

- Aplikacionit të kandidates **Djelza Panxhaj** i mungon kërkesa për pozitën nr. 14: të konkursit të Universitetit të Prishtinës (të datës 25.07.2024) në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore prandaj dokumentacioni **nuk shqyrtohet**.
- Aplikacioni i kandidatit **Granit Osaj** i plotëson kriteret sipas Nenin 7, paragrafi 3 (3.1, 3.2.) të rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 2/254 datë 17.07.2024, mirëpo kandidati i mungon përvoja e punës në fushën përkatëse,



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

prandaj i refuzohet angazhimi për mbajtjen e ushtrimeve të lëndëve sipas pozitës nr. 14 të konkursit të Universitetit të Prishtinës (të datës 25.07.2024) në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore.

➤ Aplikacioni i kandidatit **Avdyli Bajrami** nuk i plotëson kriteret sipas Nenin 7, paragrafi 3 (3.2.) të rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 2/254 datë 17.07.2024, prandaj i **refuzohet angazhimi** për mbajtjen e ushtrimeve të lëndëve sipas pozitës nr. 14: të konkursit të Universitetit të Prishtinës (të datës 25.07.2024) në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore.

➤ Aplikacionit të kandidatit **Besnik Dakaj** i *mungon kërkesa për pozitën nr. 14: të konkursit të Universitetit të Prishtinës (të datës 25.07.2024)* në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore *prandaj dokumentacioni nuk shqyrtohet.*

➤ Aplikacioni i kandidatës **Mirilinda Dehari Zeka** i plotëson kriteret sipas Nenin 7, paragrafi 3 (3.1 dhe 3.2) të rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 2/254 datë 17.07.2024, mirëpo kandidatës i mungon përvoja e punës në fushën përkatëse, prandaj i **refuzohet angazhimi** për mbajtjen e ushtrimeve të lëndëve sipas pozitës nr. 14 të konkursit të Universitetit të Prishtinës (të datës 25.07.2024) në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore.

➤ Aplikacionit të kandidatës **Besa Brahim Balaj** i *mungon kërkesa për pozitën nr. 14: të konkursit të Universitetit të Prishtinës (të datës 25.07.2024)* në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore *prandaj dokumentacioni nuk shqyrtohet.*

➤ Aplikacioni i kandidatit **Ylli Krasniqi** i plotëson kriteret sipas Nenin 7, paragrafi 3 (3.1, 3.2.) të rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 2/254 datë 17.07.2024. Duke u bazuar në përvojën nga fusha përkatëse. Kandidati **pas** përfundimit të studimeve themelore në fushën **Biologji Bsc** në Universitetin e Prishtinës Hasan Prishtina në FSHMN në





## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Departamenti e Biologjisë, i vazhdoi studimet pasdiplomike të nivelit **Master në Biomjekësi të përgjithshme** (me fokus në onkologji dhe fiziologji) të cilat i ka kryer në Universitetin e Eskisehrit "Osmanгази University" në Turqi, aktualisht është student i studimeve të **Doktoratürës** në fushën e Biomjekësisë së përgjithshme në "Hacettepe University" në Ankara në Turqi ( i ranguar si i pari në Turqi).

Aktiviteti arsimor- kandidati Ylli Krasniqi ka përvojë pure në arsimin e lartë në kohëzgjatje prej tri viteve, dy prej të cilave si asistent i lëndës "Biomjekësi të përgjithshme" në Universitetin e Eskisehrit "Osmanгази University" në Turqi, duke treguar performancë të lartë në procesin e detyrës së asistentit dhe një vit si asistent i angazhuar për lëndët: Fiziologji krahasuese (O-Bio)Bsc; Makro dhe mikroanatomia e shtazëve laboratorike (Z-Bio) Msc; Kaptuj të zgjedhur nga Fiziologjia animale (O-Bio) Msc; Fiziologji e shtazëve (O-Eko)Bsc; Fiziologji e përgjithshme (O-Bio) Bsc; Parimet e qëndrueshmërisë mjedisore (Z-Eko) Bsc, ku ka treguar cilësi të larta interpretuese dhe komunikuese me një performancë shumë të lartë.

Aktiviteti shkencor i kandidatit Ylli Krasniqi poashtu vlerësohet lartë, pasi që nga rezultatet e temës së masterit të cilën e ka përmbyllur me sukses të plotë, ka të publikuara një punim dhe një punime tjetër i cili është pranuar dhe është në pritje të publikimit, pjesëmarrës në konferenca ndërkombëtare ku ka gjithashtu tele certifikata të cilat deshmojnë se ka prezantuar në këto konferenca. Ylli Krasniqi është gjithashtu dhe bashkëautorë në librin "Molecular Mechanism of Pyroptosis and Cancer.

Medical and Health Sciences Studies 2022" (pp.295-324). Po ashtu kandidati ka qene dhe sekretar i conferences 8th INTERNATIONAL CONGRESS on APPLIED BIOLOGICAL SCIENCES te organizuar nga Universiteti i Prishtines dhe Universiteti i Osmangazit, ku Ai ishte nderlicthes ne mes te dy universiteteve. Kandidati po ashtu zotëron certifikaten mbi hulumtimet për punë me katshë laboratorike, certifikatë kjo e cila njihet ne te gjithë universitetet botërore. Bazuar në përgatitjen e tij, kandidati në fjalë zotëron përgatitje të lartë profesionale të fushës së ngushtë të lëndëve të propozuara më lartë, shkathtësi komunikimi dhe bashkëpunimi, trajnime dhe kualifikime për metodat dhe teknikat laboratorike bashkëkohore, gjatë kësaj kohe sa ka qenë i angazhuar në FSHMN, ka bashkëpunuar ngushtë me mbi 20 kandidatë të temave të diplomës në teren dhe laborator, duke treguar një komunikim, zgjerim dhe thellim të shkathtësive interpretuese me pajisjet dhe teknikat më të reja laboratorike.



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Prandaj, kemi kënaqësinë që duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi paragrafin 3 (3.1, 3.2.) dhe 4 të rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm (nr. 2/254 datë 17.07.2024), kandidatin Ylli Krasniqi ta propozojmë si bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve nga lëndët sipas pozitës 14 (Ekofiziologji (O-Eko) Msc; Ekotoksikologji (O-Eko) Msc; Fiziologji e përgjithshme (O-Bio) Bsc; Fiziologji e shtazëve (O-Bio)Bsc; Fiziologji krahasuese (O-Bio)Bsc; Hulumtimi në laborator dhe vivariumi (Z-Bio) Bsc; Kafshët laboratorike në hulumtime në biologjinë molekulare (O-BioM) Bsc;Kapituj të zgjedhur nga Fiziologjia animale (O-Bio) Msc;Makro dhe mikroanatomia e shtazëve laboratorike (Z-Bio) Msc;Menaxhimi dhe mbrojta e tokave (Z-Eko) Msc; Metodat hulumtuese të acideve nukleike dhe proteinave (O-BioM) Bsc; Parimet e qëndrueshmërisë mjedisore (Z-Eko) Bsc;Preparimi i shtazëve (Z-Bio) Msc ), të konkursit të Universitetit të Prishtinës (të datës 25.07.2024) në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore.

Komisioni vlerësues:

1. Prof. Dr. Kemal Bislimi, kryetar
2. Prof. Ass. Ilir Mazreku, anëtar
3. Prof. Dr. Elez Krasniqi, anëtar